

V E N D I M
Nr.10, datë 30.11.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/kryetar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 21.10.1994 dhe 30.11.1994 shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 Akti, që i përket :

KËRKUESVE: 1.VLADIMIR TOROVECI, 2.DHORI KITA, 3.MERIBAN MULLAJ, 4.KOÇO ZOGRAFI, 5.NIKOLETA ZOGRAFI, 6.LIRIKA NGJELA,7.VISKA KOSTI, 8.RAJMONDA RAUDHI, 9.VLADIMIR NIKOLLA, 10.XIKO GORA, 11.RAMADAN QELEMENI, 12.IRENA QIRJA, 13.TATJANA ZOTO, 14.DHIONIS PAPA, 15.KOÇO SORKADHE.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i nenit 11 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", si antikushtetues.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe :

Kemi blerë nga shteti në muajt janar e shkurt 1991 nga një copë truall për të ndërtuar banesë individuale;

Blerjen e kemi bërë me mirëbesim;

Nuk kemi mundur deri më sot të ndërtojmë pasi jemi penguar nga organet e pushtetit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin pëkatës,

V Ë R E N:

Neni 11 i ligjit të mësipërm përcakton : "Në rastin kur trualli i ish-pronarit është tjetërsuar në persona të tretë dhe mbi të nuk ka ndërtesa të përhershme, i kthehet ish-pronarit, ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve".

Përmbajtja e këtij neni pajtohet me atë të nenit 1 të të njëjtit ligj që ia njeh ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti në çdo mënyrë tjetër. Po ashtu në nenin 4 po të atij ligji i njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të gjitha pronat që në momentin e daljes së ligjit (nr.7698, datë 15.4.1993) ekzistojnë në formën e trojeve të pazëna apo ndërtesave të pandryshuara, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

Derisa me ligj njihet se ato troje i janë marrë pa të drejtë ish-pronarëve nga shteti, me nenin 11 rivendoset e drejta e tyre. Nuk gjen mbështetje as pretendimi i blerjes me mirëbesim sepse dihej prejardhja e pronësisë së shtetit që e kishte burimin nga marrja e padrejtë e trojeve të ish-pronarëve. Nga ana tjetër blerësit në këtë rast nuk dëmtohen sepse shteti u kthen masën e shpërblimit e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

Përsa i përket pronësisë së trojeve në favor të ish-pronarëve kjo është pranuar edhe me vendimet e mëparshme të kësaj Gjykate për rastin e nenit 10 e 13 të ligjit me të cilët duke iu njohur dhe duke iu kthyer pronësia ish-pronarit mbi ndërtesën, njëkohësisht i është njohur edhe pronësia mbi truallin mbi të cilin është ngritur ndërtesa, me arsyetimin se edhe në këto raste nuk është shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese, por është rivendosur një e drejtë pronësie e marrë pa të drejtë nga shteti i

mëparshëm.

Lidhur me pretendimin e kërkuësve se organet e pushtetit lokal kanë penguar ndërtimin e banesave e objekteve të tjera mbi këto troje, duke pezulluar çdo veprim në këtë drejtim, Gjykata çmon se nuk është kryer prej tyre ndonjë akt i kundërligjshëm. Përkundrazi, përderisa ka qenë në diskutim nga organet shtetërore kompetente, çështja e kthimit të pasurive të paluajtshme, që kanë qenë në pronësi private, dhe përderisa më pas me ligj të veçantë është vendosur që këto pasuri t'u kthehen ish-pronarëve, organet e pushtetit lokal me të drejtë nuk kanë dhënë leje për ndërtime. Në këtë mënyrë ato kanë parandaluar konfliktet midis qytetarëve dhe pasojat e tjera negative, që mund të shkaktoheshin po të mbahej qëndrim i kundërt.

PER KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 2, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës së ankuesve për shfuqizimin e nenit 11 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më 30.11.1994

MENDIMI I PAKICES

Unë Feti Gjilani, zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese, kam votuar për rrëzimin e kërkesës së subjekteve të lartpërmendur, me objekt shpalljen antikushtetues të nenit 11 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, por nuk jam pajtuar e nuk pajtohem me mendimin e shumicës që të mos përfshihet në pjesën hyrëse e të mos trajtohet fare në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi një ndër shkaqet kryesore ku është mbështetur kjo kërkesë.

Më konkretisht, shtetasi Vladimir Toroveci dhe 13 subjektët e tjerë të lartpërmendur në kërkesën, që i kanë paraqitur për kompetencë kësaj Gjykate, kanë pretenduar shprehimisht se neni 11 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 duhet të shfuqizohet mbi bazën e të njëjtit arsyetim me të cilin kjo Gjykatë, nëpërmjet vendimit të saj nr.4, datë 8 prill të vitit në vazhdim (Fletorja Zyrtare Nr.5, viti 1994) ka shpallur antikushtetues paragrafin 1 të nenit 12 të po atij ligji.

Ky pretendim i kërkuësve nuk mund të lihej në heshtje të plotë nga Gjykata Kushtetuese, por duhej rrëzuar me arsyetimin krejt racional se ndërsa neni 11 rregullon “rastet kur trualli i ish-pronarit është tjetërsuar në persona të tretë dhe mbi të nuk ka ndërtesa të përhershme...”, përkundrazi paragrafi 1 i nenit 12 bënte fjalë për ato troje të zëna nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991 për ndërtimin, sipas lejeve përkatëse të organeve kompetente, të banesave individuale dhe lokaleve të tregtisë a të shërbimeve.

Kjo heshtje, që është lejuar në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, vjen në kundërshtim të hapur me rregullin procedural të gjithëpranuar me vijimësi prej shumë shekujsh, i cili përcakton se çdo instancë gjyqësore është e detyruar që në vendimin përfundimtar të saj t'i përgjigjet çdo pretendimi thelbësor të parashtruar nga subjekti i legjitimuar në aktin përkatës, sepse përndryshe dobësohet shumë forca argumentuese e bindëse e vendimit përfundimtar si edhe besimi në bazueshmërinë apo vërtetësinë e tij.

Tiranë, më 30.11.1994

ZV.K R Y E T A R
F. Gjilani

ARSYETIM PARALEL

Unë Veli Budo, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kam votuar për rrëzimin e kërkesës së subjekteve të lartpërmendur, me objekt shpalljen antikushtetues të nenit 11 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, por nuk pajtohem me mendimin e shumicës që të mos përfshihet në pjesën hyrëse e të mos trajtohet fare në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi një ndër shkaqet kryesore ku është mbështetur kjo kërkesë.

Më konkretisht, shtetasi Vladimir Toroveci dhe 13 subjektet e tjerë të lartpërmendur në kërkesën, që i kanë paraqitur për kompetencë kësaj Gjykate, kanë pretenduar shprehimisht se neni 11 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 duhet të shfuqizohet mbi bazën e të njëjtit arsyetim me të cilin kjo Gjykatë, nëpërmjet vendimit të saj nr.4, datë 8 prill të vitit në vazhdim (Fletorja Zyrtare nr.5, viti 1994) ka shpallur antikushtetues paragrafin 1 të nenit 12 të po atij ligji.

Ky pretendim i kërkuarve nuk mund të lihej në heshtje të plotë nga Gjykata Kushtetuese, por duhej rrëzuar me arsyetimin krejt racional se ndërsa neni 11 rregullon “rastet kur trualli i ish-pronarit është tjetërsuar në persona të tretë dhe mbi të nuk ka ndërtesa të përhershme...”, përkundrazi paragrafi 1 i nenit 12 bënte fjalë për ato troje të zëna nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991 për ndërtimin, sipas lejeve përkatëse të organeve kompetente, të banesave individuale dhe lokaleve të tregtisë a të shërbimeve.

Ky qëndrim, i mbajtur në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, vjen në kundërshtim të hapur me rregullin procedural, i cili përcakton se çdo instancë gjyqësore është e detyruar që në vendimin përfundimtar të saj t’i përgjigjet çdo pretendimi thelbësor të parashtruar nga subjekti i legjitimuar në aktin përkatës.

Tiranë, më 30.11.1994